



**REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E BRENDSHME
AGJENCIA E BLERJEVE TË PËRQENDRUARA**

DOKUMENTAT E TENDERIT

“BLERJE DHE SHPËRNDARJE E UNIFORMAVE DHE KËPUCËVE TË POLICISË SË SHTETIT”

PROCEDURË E KUFIZUAR - MALLRA ¹

Marrëveshje kuadër me 1 operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara.

I. NJOFTIMI I KONTRATËS

Seksioni 1. Autoriteti Kontraktor

1.1 Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.
Adresa Sheshi Skënderbej Nr. 3, Tiranë.
Tel/Fax +355 42 256 796
Faqja në Internet ëëë.abp.gov.al
Përsoni përgjegjës: Znj. Flutura ÇEKREZI
E-mail Flutura.Cekrezi@mb.gov.al

1.2 Lloji i autoritetit kontraktor:

Institucion qendror	Institucion i pavarur
X	
Njësi e qeverisjes vendore	Tjetër

1.3 Kontratë në kuadrin e një Marrëveshjeje të veçantë ndërmjet Shqipërisë dhe një Shteti tjetër

Po Jo **X**

Seksioni 2 Objekti i kontratës

2.1 Numri i referencës së procedurës: REF-31606-07-25-2019

2.2 Lloji i “Kontratave Publike për Mallra”

Blerje Qira Leasing Blerje me këste Një kombinim i tyre
X

2.3 Kontratë në bazë të Marrëveshjes Kuadër

Po **X** Jo

2.4 Lloji i Marrëveshjes Kuadër

Me një Operator Ekonomik **X**
Me disa operatorë ekonomikë
Të gjitha kushtet janë të përcaktuara Po **X** Jo

Në Marrëveshjen Kuadër me 1 Operator Ekonomik, kur të gjitha kushtet janë të përcaktuara, të jepen arsyet e përzgjedhjes së kësaj lloji Marrëveshje Kuadër

- Nisur nga natyra e këtij objekti prokurimi, për të cilin është e pamundur të parashikohen me saktësi sasi të mallrave, sipas masave konkrete të punonjësve të policisë, që do të jenë të nevojshme për furnizim, për një periudhë të paktën 4 vite.
- Për shkak të karakterit shumë të ndërlikuar dhe të veçantë të mallrave e shërbimeve në lidhje me to, ku kombinohen disa detyra - nga evidentimi i përmasave trupore të punonjësve të policisë, ngritja e sistemit elektronik të porositjes dhe shpërndarjes së mallrave, pajisja e punonjësve të Policisë së Shtetit me karta me pikë, prodhimi/konfeksionimi i mallrave, deri në marrjen e produktit përfundimtar nga punonjësi i policisë - është e domosdoshme që mallrat dhe shërbimet objekt prokurimi, të furnizohen, sigurohen dhe ekzekutohen nga 1(një) operator ekonomik.
- Për shkak të plotësimit të nevojës së autoritetit kontraktor DPPSH, me një lloj veshje uniform, të njëjtë nga koka te këmbët për të gjithë punonjësit e policisë (uniforma dhe këpucë), ku modeli i përcaktuar, materialet e përdorura, cilësia në prodhim, tonacioni i ngjyrave, nuk duhet të ndryshojnë jo vetëm brenda një uniforme të një punonjësi por as edhe ndërmjet punonjësve me njëri-tjetrit, pra nga prodhimi i lëndës së parë, prodhimi i fijeve dhe kopsave e deri te ndërtimi i saj, duhet të realizohet në mënyrë uniforme. Pra, nga ana teknike dhe organizative është e nevojshme kryerja e furnizimit me uniforma vetëm nga një operator ekonomik, i cili duhet të

realizojë edhe porositjen e shpërndarjen nëpërmjet sistemit elektronik të shpërndarjes së uniformës, tek të gjithë punonjësit e policisë së shtetit në të gjithë vendin, si dhe pajisjen e tyre me karta, me të njëjtat standarde, për një periudhë të paktën 4 vite.

Për gjithë sa më sipër, në zbatim të pikës 1/a) të **Nenit 47 (Llojet e marrëveshjes kuadër)** të VKM-së nr.914 datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit Publik” (i ndryshuar) do te përdoret marrëveshja kuadër me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara.

2.5 Numri i operatorëve ekonomikë me të cilët do të perfundojë Marrëveshja Kuadër: 1 (NJË) (Këtu duhet të përcaktohet numri maksimal i operatorëve ekonomikë me të cilët do të lidhet Marrëveshja Kuadër).

2.6	Kushtet që do zbatohen në rastin e rihapjes së konkurimit dhe/ose përdorimi i mundshëm i blerjes elektronike .	
------------	--	--

2.7 Autoriteti kontraktor/Autoritetet kontraktore të cilat do të lidhin marrëveshjen kuadër:
Marrëveshja Kuadër do të lidhet nga Organi Qendror Blerës ABP, në emër e për llogari të autoritetit kontraktor Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

1.8 Përshkrim i shkurtër i marrëveshjes kuadër

- Fondi limit/ Vlera e pritshme e kontratës: **2.800.347.570 (dymiliard e tetëqindmilion e treqindedyzetëeshtatëmijë e pesëqindeshtatëdhjetë) Lekë (pa TVSH).**
- Në rastin kur objekti i prokurimit përbëhet nga disa artikuj, shumatorja e çmimeve për njësi është: **21.982.366 (njëzetënjëmilion e nëntëqind e tetëdhjetëedymijë e treqindegjashtëdhjetëegjashtë) Lekë (pa TVSH), ku përfshihet:**
 - Shumatorja e çmimeve për njësi të artikujve të veshjeve dhe këpucëve: 488.141 (katërqind e tetëdhjetë e tetëmijë e njëqind e dyzetë e një) Lekë (pa TVSH)
 - Shumatorja e çmimeve për njësi të zërave të sistemit elektronik të shpërndarjes së uniformës dhe këpucëve: 21.494.225 (njëzetënjëmilion e katërqindnëntëdhjetë e katërmijë e dyqindnjëzetëepesë) Lekë (pa TVSH).
- Burimi i Financimit: **Buxheti i Shtetit.**
- Objekti i marrëveshjes kuadër: **“Blerje dhe shpërndarje e uniformave dhe këpucëve të Policisë së Shtetit”, për 4 vjet (2019-2022).**

2.9 Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin:

Kohëzgjatja në muaj ose ditë

ose

duke filluar nga // me përfundim në //

Brenda datës 1 Prill për artikujt e uniformës verore dhe brenda datës 1 Shtator për artikujt e uniformës dimërore. Përjashtimisht, afati kohor për ekzekutimin e kontratës së parë që do të nënshkruahet brenda Marrëveshjes Kuadër, do të jetë jo më pak se 60 ditë nga lidhja e kontratës.

2.9.1. Kohëzgjatja e Marrëveshjes Kuadër

Kohëzgjatja në muaj: 48 Muaj ose ditë: (nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ jo më shumë se (4) vjet)
Ose duke filluar nga // (dd/mm/vvvv)
Përfunduar më // (dd/mm/vvvv)

2.10 Vendi i dorëzimit të objektit të kontratës/marrëveshjes kuadër:

Tek secili punonjës i Policisë së Shtetit.

2.11 Ndarja në LOTE:

Po Jo X

Nëse po,

2.12 Përshkrim i shkurtër i loteve

(Objekti dhe fondi limit i loteve)

1. _____

2. _____

3. _____

Një Ofertues mund të aplikojë për [një lot], [disa lote], [të gjitha lotet]. Për çdo lot paraqitet një ofertë e veçantë.

2.13 Opsionet:

Numri i rinovimeve të mundshme (nëse ka):

ose: nga në

2.14 Do të pranohen variantet:

Po Jo X

2.14.1 Do të pranohet nenkontraktimi:

Po X Jo

Nese do te lejohet nenkontraktimi, te specifikohet perqindja e lejuar per nenkontraktim: deri në 40 % të vlerës së kontratës / kontratave.

Autoriteti kontraktor do t'i beje pagesa te drejperdrejte nenkontraktorit:

Po Jo X

Shenime te tjera

Autoriteti Kontraktor, Drejtorja e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, lejon nënkontraktimin e operatorëve vendas ose të huaj, të cilët do të kryejnë shërbime deri në 40 % të vlerës së kontratës. Autoriteti kontraktor nuk do ti kryejë pagesa të drejtpërdrejta nënkontraktorit.

Autoriteti kontraktor do t'i beje pagesa te drejperdrejte nenkontraktorit:

Po Jo X

Shenime te tjera

- Operatori ekonomik duhet të deklarojë artikujt dhe shërbimet që do të kryejë si dhe emrin e nënkontraktorit.
- Nënkontraktorët gjithashtu duhet të kenë kapacitetet teknike dhe njerëzore për realizimin në kohë dhe me cilësi të objekteve.
- Përpara lidhjes së kontratës, ofertuesi i shpallur fitues duhet t'i dorëzojë autoritetit kontraktor një kopje të noterizuar të marrëveshjes së nënkontraktimit dhe dëshminë e kualifikimeve e të kërkesave teknike të nënkontraktorit, në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktor të mund të miratojë nënkontraktimin. Komisioni i vlerësimit të ofertave vlerëson nëse nënkontraktori plotëson kërkesat e nenit 45 të LPP, si dhe zotëron kualifikimet teknike për pjesën e punës e të shërbimeve që do të kryejë ose për mallrat që do të furnizojë.
- Në rast të mosplotësimit nga nënkontraktori të kriterëve të kërkuara, autoriteti kontraktor vijon me lidhjen e kontratës me operatorin ekonomik të shpallur fitues.
- Gjatë ekzekutimit të kontratës autoriteti kontraktor duhet të kontrollojë nëse pjesa e kontratës, e marrë përsipër për t'u realizuar nga nënkontraktori, po realizohet nga ky i fundit. Në rast se autoriteti kontraktor konstaton se nënkontraktori nuk po realizon pjesën e kontratës së marrë përsipër i kërkon kontraktorit kryesor të ndërpresë nënkontraktimin dhe të vijojë me zbatimin e kontratës.

2.15. Gjatë procesit të prokurimit në fushën e Teknologjisë të Informacionit dhe Komunikimit (TIK) janë përdorur standartet e përgatitura nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit:

Po X Jo

2.16. Gjatë procesit të prokurimit në fushën e Teknologjisë të Informacionit dhe Komunikimit (TIK), në rastin kur standartet janë të pa-aplikueshme, është marrë miratimi paraprak nga Agjencia Kombëtare e

Shoqërisë së Informacionit:

Po X Jo

Seksioni 3 Informacioni ligjor, ekonomik, financiar dhe teknik

3.1 Kriteret e Pranimit sipas Shtojcës 10.

3.2 Sigurimi i Ofertës¹: (i zbatueshëm në rastin e procedurave të prokurimit me vlerë më të lartë se kufiri i lartë monetar, në rast se kërkohet nga autoriteti kontraktor).

Operatori Ekonomik paraqet Formularin e sigurimit të ofertës, kur kërkohet, **sipas Shtojcës 5.**

Vlera e kërkuar e sigurimit të ofertës është 56.006.952 Lekë (pesëdhjetëegjashhtëmilion e gjashtëmijë e nëntëqindpesëdhjetëedy) (shuma e shprehur në fjalë), në formën e një garancie bankare, nga një institucion bankar i nivelit të dytë, vendas ose i huaj.

Në rastet e dorëzimit të ofertës për Lote, vlera e sigurimit të ofertës për secilin nga Lotet është si më poshtë:

Loti 1 _____ Lekë

Loti 2 _____ Lekë

Seksioni 4 Procedura

4.1 Lloji i procedurës: E Kufizuar

Procedurë prokurimi e rishpallur

Po Jo X

Nëse është procedurë e rishpallur të plotësohen të dhënat identifikuese të procedurës së anuluar:

a) Numri i referencës në sistemin e prokurimit elektronik të procedurës së prokurimit të anuluar _____

b) Objekti i prokurimit të procedurës së prokurimit të anuluar _____

c) Fondi limit i procedurës së prokurimit të anuluar _____

Kjo procedurë përfshin dy faza kryesore:

Faza 1 – Parakualifikimi: Kandidatët do të dorëzojnë dokumentat e kërkuara në DT. Autoriteti Kontraktor, do të shqyrtojë dokumentat e dorëzuara nga Kandidatët dhe do të vlerësojë nëse ky dokumentacion plotëson kërkesat e kualifikimit të përcaktura në dokumentat e tenderit.

Faza 2 – Ftesa për Ofertë: Autoriteti Kontraktor do të dërgojë një ftesë për ofertë tek Kandidatët të cilët kanë plotësuar kërkesat për para-kualifikim duke i ftuar të dorëzojnë një ofertë teknike dhe ekonomike. Ofertat do të shqyrtohen dhe vlerësohen nga Autoriteti Kontraktor për të përcaktuar ofertën, fituese.

4.2 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A) çmimi më i ulët

Ose

B) oferta ekonomikisht më e favorshme X

lidhur me rëndësinë: **Çmimi / Oferta Ekonomike**

0 - 50 pikë

Oferta Teknike

0 - 50 pikë

Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100.

- I. Vlerësimi i Ofertës Ekonomike** do të bëhet duke u bazuar vetëm në shumatoren e çmimeve për njësi (të artikujve të uniformës dhe zërave të sistemit elektronik të shpërndarjes së uniformës, të marra së bashku).

Në cdo rast, operatorët ekonomik duke iu referuar sasive të pritshme përkatëse, nuk duhet të tejkalojnë as shumatoren limit të artikujve të uniformës, as fondin limit të sistemit elektronik të shpërndarjes së uniformës, dhe as vlerën e pritshme të kontratës (fondin limit të marrëveshjes kuadër).

Pesha specifike e kriterit të cmimit dhe konkretisht pikët maksimale që do të ketë ky kriter, janë 50 pikë. Pikët maksimale do t'i jepen ofertuesit i cili paraqet shumatoren e çmimeve për njësi më të ulët (të artikujve të uniformës dhe zërave të sistemit elektronik të shpërndarjes së uniformës, të marra së bashku), ndërsa për ofertuesit e njëpasnjëshëm pikët do të jepen proporcionalisht në rend zbritës. Mënyra e llogaritjes së pikëve për ofertuesit e njëpasnjëshëm, do të jetë sipas formulës së parashikuar në dokumentet standarde të tenderit, në kapitullin "Udhëzime për operatorët ekonomik", seksioni Seksioni 5 "Vlerësimi i Ofertave - Kriteret e përzgjedhjes", Opsioni 2 - Oferta ekonomike më e favorshme.

- II. Vlerësimi i Ofertës Teknike** do të bëhet duke u bazuar, në kriteret e peshuara me pikë, si vijon:

- | | |
|--|-----------------------------|
| 1. Kapacitete teknike: | 0 - 15 pikë në total |
| a) Vlera e furnizimeve të ngjashme për prodhimin dhe shpërndarjen e veshjeve të të njëjtës natyrë (veshje të jashtme uniforma policie, ushtarake, garde, forca speciale, marine, etj). | 0 - 12 pikë |
| b) Vlera e furnizimeve të ngjashme për prodhimin dhe shpërndarjen e këpucëve të të njëjtës natyrë (këpucë uniforme policie, ushtarake, garde, forca speciale, marine, etj). | 0 - 3 pikë |

Sipas kriterit të përcaktuar në pikën 1 të seksionit B "Oferta Teknike" të pikës III "Dokumentacioni që duhet të paraqitet në Fazën II, nga kandidatët e kualifikuar në Fazën e I", të shtojcës 10 të dokumentave të tenderit.

Pesha specifike e këtij kriteri teknik dhe konkretisht pikët maksimale që do të ketë ky kriter janë **15 pikë**, nga të cilat **12 pikë** do ti jepen ofertuesit i cili paraqet vlerën më të lartë të furnizimeve të ngjashme për prodhimin dhe shpërndarjen e veshjeve të të njëjtës natyrë dhe **3 pikë** do ti jepen ofertuesit i cili paraqet vlerën më të lartë të furnizimeve të ngjashme për prodhimin dhe shpërndarjen e këpucëve të të njëjtës natyrë, ndërsa për ofertuesit e njëpasnjëshëm pikët do të jepen proporcionalisht në rend zbritës. Mënyra e llogaritjes së pikëve për ofertuesit e njëpasnjëshëm, do të jetë sipas formulës së parashikuar në dokumentet standarde të tenderit, në kapitullin "Udhëzime për operatorët ekonomik", seksioni Seksioni 5 "Vlerësimi i Ofertave - Kriteret e përzgjedhjes", Opsioni 2 - Oferta ekonomike më e favorshme.

- | | |
|--|----------------------------|
| 2. Kapacitete njerëzore: | 0 - 5 pikë në total |
| a) Numri i fuqisë punëtore | 0 - 1 pikë |
| b) Certifikatat e stafit teknik të sistemit elektronik të shpërndarjes | 0 - 2 pikë |
| c) Kualifikimet e stafit teknik për prodhimin dhe shpërndarjen e uniformës | 0 - 2 pikë |

Sipas kriterëve të përcaktuar në pikat 2, 3 dhe 4 të seksionit B "Oferta Teknike" të pikës III "Dokumentacioni që duhet të paraqitet në Fazën II, nga kandidatët e kualifikuar në Fazën e I", të shtojcës 10 të dokumentave të tenderit.

Pesha specifike e këtij kriteri teknik dhe konkretisht pikët maksimale që do të ketë ky kriter janë **5 pikë**, nga të cilat **1 pikë** do ti jepet ofertuesit i cili paraqet numrin më të lartë të punonjësve fuqi punëtore të angazhaur me prodhimin dhe shpërndarjen e veshjeve dhe këpucëve; **2 pikë** do ti jepet ofertuesit i cili paraqet numrin më të lartë të stafit teknik të certifikuar të angazhaur për krijimin, zhvillimin, instalimin, mirëmbajtjen e sistemit elektronik të shpërndarjes së uniformës dhe trajnimin për përdorimin e sistemit elektronik të shpërndarjes; **2 pikë** do ti jepet ofertuesit i cili paraqet numrin më të lartë të stafit teknik të kualifikuar, të angazhaur për prodhimin dhe shpërndarjen

"Blerje dhe shpërndarje e uniformave dhe këpucëve të Policisë së Shtetit"

e artikujve të uniformës; ndërsa për ofertuesit e njëpasnjëshëm pikët do të jepen proporcionalisht në rend zbritës. Mënyra e llogaritjes së pikëve për ofertuesit e njëpasnjëshëm, do të jetë sipas formulës së parashikuar në dokumentet standarde të tenderit, në kapitullin “Udhëzime për operatorët ekonomik”, seksioni Seksioni 5 “Vlerësimi i Ofertave - Kriteret e përzgjedhjes”, Opsioni 2 - Oferta ekonomikisht më e favorshme.

3. Sistemi elektronik i shpërndarjes:

0 - 5 pikë në total

- | | |
|---|------------|
| a) Demo e sistemit elektronik të shpërndarjes i aksesueshëm nëpërmjet një linku në internet | 0 - 3 pikë |
| b) Manuali i përdorimi të sistemit elektronik të shpërndarjes së uniformës | 0 - 1 pikë |
| c) Marrëdhënie partneriteti me prodhuesin e teknologjive dhe instrumentave | 0 - 1 pikë |

Sipas kriterit të përcaktuar në pikën 5 dhe 6 të seksionit B “Oferta Teknike” të pikës III “Dokumentacioni që duhet të paraqitet në Fazën II, nga kandidatët e kualifikuar në Fazën e I”, të shtojcës 10 të dokumentave të tenderit.

Pesha specifike e këtij kriteri teknik dhe konkretisht pikët maksimale që do të ketë ky kriter janë **5 pikë**, nga të cilat **3 pikë** do ti jepen ofertuesit i cili paraqet një demo të sistemit elektronik të shpërndarjes së uniformës, ku gjejmë pasqyrim dhe zgjidhje të gjitha kërkesat funksionale të sistemit të përcaktura në termat e referencës dhe njëkohësisht është i thjeshtë dhe i kuptueshëm për përdorim; **1 pikë** do ti jepet ofertuesit i cili paraqet manualin e përdorimi të sistemit elektronik të shpërndarjes së uniformës, ku shpjegohet në mënyrë sa më të detajuar dhe të kutueshme përdorimi i sistemit elektronik të shpërndarjes; **1 pikë** do ti jepet ofertuesit i cili paraqet dokumentin që vërteton marrëdhënien e partneriteti të nivelit Gold ose ekuivalent, me prodhuesin e teknologjive dhe instrumentave të përdorura për prodhimin e sistemit elektronik të ofruar (marrëveshje bashkëpunimi ose kontratë partneriteti ose cdo dokument tjetër që provon këtë marrëdhënie). Për ofertuesit e njëpasnjëshëm pikët do të jepen proporcionalisht në rend zbritës. Mënyra e llogaritjes së pikëve për ofertuesit e njëpasnjëshëm, do të jetë sipas formulës së parashikuar në dokumentet standarde të tenderit, në kapitullin “Udhëzime për operatorët ekonomik”, seksioni Seksioni 5 “Vlerësimi i Ofertave - Kriteret e përzgjedhjes”, Opsioni 2 - Oferta ekonomikisht më e favorshme.

Organi qendror blerës ka përcaktuar si arsye skualifikimi të ofertuesve në fazën e dytë, rastin e mosfrimit të manualit të përdorimi të sistemit elektronik të shpërndarjes së uniformës dhe të linkut ku mund të aksesohet një demo e sistemit në internet së bashku me kredencialet e nevojshme (username dhe pasëord), pasi mosplotësimi i këtij kriteri rrjedhimisht çon në mosrealizimin e kontratës sic është kërkuar nga autoriteti kontraktor, përse i përket porositjes dhe shpërndarjes së artikujve, të përcaktuara në specifikimet teknike dhe termat e referencës.

4. Certifikime të ofertuesit dhe mallrave: total

0 - 10 pikë në

- | | |
|---|------------|
| a) Certifikimet e ofertuesit (ISO, OEKO-TEX) | 0 - 5 pikë |
| b) Certifikimet e mallrave (certifikatat e konformitetit të këpucëve) | 0 - 5 pikë |

Sipas kriterëve të përcaktuar në pikat 7, 8, 9, 10 dhe 11, të seksionit B “Oferta Teknike” të pikës III “Dokumentacioni që duhet të paraqitet në Fazën II, nga kandidatët e kualifikuar në Fazën e I”, të shtojcës 10 të dokumentave të tenderit.

Pesha specifike e këtij kriteri teknik dhe konkretisht pikët maksimale që do të ketë ky kriter janë **10 pikë**, nga të cilat **5 pikë** do ti jepen ofertuesit i cili paraqet të gjithë dokumentacionin e kërkuar që provon certifikimet e ofertuesi, e konkretisht për tre llojet e certifikimeve ISO dhe 2 llojet e certifikimeve OEKO-TEX; **5 pikë** do ti jepen ofertuesit i cili paraqet të gjithë dokumentacionin e kërkuar që provon certifikimet e mallrave, e konkretisht pesë llojet e certifikimeve në lidhje me kërkesat e konformitetit të këpucëve. Për ofertuesit e njëpasnjëshëm pikët do të jepen proporcionalisht në rend zbritës. Mënyra e llogaritjes së pikëve për ofertuesit e njëpasnjëshëm, do të jetë sipas formulës së parashikuar në dokumentet standarde të tenderit, në kapitullin “Udhëzime për operatorët ekonomik”, seksioni Seksioni 5 “Vlerësimi i Ofertave - Kriteret e përzgjedhjes”, Opsioni 2 - Oferta ekonomikisht më e favorshme.

5. Oferta teknike: total

0 - 15 pikë në

- | | |
|-----------------------------------|-------------|
| a) Kampionet/ mostrat e artikujve | 0 - 10 pikë |
|-----------------------------------|-------------|

b) Dokumentat teknike shoqëruese të kampioneve/ mostrave (skeda teknike, deklarata vërtetësie, deklarata prodhuesi, testimet shoqëruese për këpucët)

0 - 5 pikë

Sipas kritereve të përcaktuar në pikën 12 dhe 13 të seksionit B “Oferta Teknike” të pikës III “Dokumentacioni që duhet të paraqitet në Fazën II, nga kandidatët e kualifikuar në Fazën e I”, të shtojcës 10 të dokumentave të tenderit.

Pesha specifike e këtij kriteri teknik dhe konkretisht pikët maksimale që do të ketë ky kriter janë **15 pikë**, nga të cilat **10 pikë** do ti jepen ofertuesit i cili paraqet mostrat/ kampionet e kërkuara që janë më të arrira nga ana cilësore dhe estetike, në përputhje me specifikimet teknike dhe **5 pikë** do ti jepen ofertuesit i cili paraqet dokumentacionin teknik shoqërues të kërkuar për mostrat / kampionet, që paraqesin më së miri specifikimet teknike dhe janë në përputhje me to. Për ofertuesit e njëpasnjëshëm pikët do të jepen proporcionalisht në rend zbritës. Mënyra e llogaritjes së pikëve për ofertuesit e njëpasnjëshëm, do të jetë sipas formulës së parashikuar në dokumentet standarde të tenderit, në kapitullin “Udhëzime për operatorët ekonomik”, seksioni Seksioni 5 “Vlerësimi i Ofertave - Kriteret e përzgjedhjes”, Opsioni 2 - Oferta ekonomisht më e favorshme.

Organi qendror blerës ka përcaktuar si arsye skualifikimi të ofertuesve në fazën e dytë, rastin e mosdorëzimit të mostrave/kampioneve të kërkuara, pasi mosdorëzimi i tyre e bën të pamundur vlerësimin në lidhje me realizimin e artikujve të uniformës në përputhje me specifikimet teknike nga ofertuesit, që rrjedhimisht nuk jep besueshmëri për realizimin e kontratës sic është kërkuar nga autoriteti kontraktor.

Autoriteti Kontraktor duhet të specifikojë pikët për çdo kriter vlerësimi të vendosur.

4.3 Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Data: **19/08/2019** (dd/mm/vvvv) Ora: **10:00**

Vendi: ee.app.gov.al

Kur oferta kërkohet të paraqitet me mjete elektronike operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë ofertën në mënyrë elektronike në faqen zyrtare të APP-së, ee.app.gov.al

4.4 Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Data: **19/08/2019** (dd/mm/vvvv) Ora: **10:00**

Vendi: ee.app.gov.al ; Agjencia e Blerjeve të Përqendruara në Ministrinë e Brendshme, Tiranë.

Informacioni mbi ofertat e paraqitura me mjete elektronike duhet t’i komunikohet të gjithë atyre Operatorëve Ekonomikë që kanë dorëzuar oferta, në bazë të kërkesës së tyre.

4.5 Periudha e vlefshmërisë së ofertave: **180 ditë** (e shprehur në ditë)

4.6 Gjuha(-ët) për hartimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Shqip	X	Anglisht	X
Tjetër		_____	

Seksioni 5 Informacione plotësuese

5.1 Dokumenta me pagesë (i zbatueshëm vetëm për procedurat që nuk zhvillohen me mjete elektronike):

Po	Jo	X
-----------	-----------	----------

Nëse Po

Monedha	_____	Çmimi	_____
---------	-------	-------	-------

Ky çmim mbulon kostot aktuale të kopjimit dhe shpërndarjes së DT tek Operatorët Ekonomik. Operatorët Ekonomikë të interesuar kanë të drejtë të kontrollojnë DT para blerjes së tyre.

5.2 Informacione shtesë (vendi, zyra, mënyrat për tërheqjen e dokumentave të tenderit)

Data e shpërndarjes së këtij njoftimi **26/07/2019**

Njoftimi i kontratës për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor, i cili do të publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike

1. Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri	Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.
Adresa	Sheshi Skënderbej Nr. 3, Tiranë.
Tel/Fax	+355 42 256 796
Faqja në Internet	ëëë.abp.gov.al
Përsoni përgjegjës:	Znj. Flutura ÇEKREZI
E-mail	Flutura.Cekrezi@mb.gov.al

2. Lloji i procedurës së prokurimit: “Procedurë e Kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar” - Prokurim Elektronik, nëpërmjet Marrëveshjes Kuadër, me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat të marrëveshjeve kuadër 4 (katër) vite.

3. Numri i referencës së procedurës: REF-31606-07-25-2019

4. Objekti i marrëveshjes kuadër: “Blerje dhe shpërndarje e uniformave dhe këpucëve të Policisë së Shtetit”.

5. Fondi limit: 2.800.347.570 (dymiliard e tetëqindmilion e treqindedyzetëeshtatëmijë e pesëqindeshtatëdhjetë) Lekë (pa TVSH).

5.1 Shumatorja e çmimeve për njësi është: 21.982.366 (njëzetënjëmilion e nëntëqind e tetëdhjetëedymijë e treqindëgjashtëdhjetëegjashtë) Lekë (pa TVSH), ku përfshihet:

- Shumatorja e çmimeve për njësi të artikujve të veshjeve dhe këpucëve është: 488.141 (katërqind e tetëdhjetë e tetëdhjetë e njëqind e dyzetë e një) Lekë (pa TVSH)

dhe

- Shumatorja e çmimeve për njësi të zërave të sistemit elektronik të shpërndarjes së uniformës dhe këpucëve është: 21.494.225 (njëzetënjëmilion e katërqindnëntëdhjetë e katërmijë e dyqindnjëzetëepesë) Lekë (pa TVSH).

6. Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin: Brenda datës 1 Prill për artikujt e uniformës verore dhe brenda datës 1 Shtator për artikujt e uniformës dimërore. Përjashtimisht, afati kohor për ekzekutimin e kontratës së parë që do të nënshkruhet brenda Marrëveshjes Kuadër, do të jetë jo më pak se 60 ditë nga lidhja e kontratës së parë.

7. Afati kohor për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje: Data: **19/08/2019**, Ora: **10:00**; në ëëë.app.gov.al .

8. Afati kohor për hapjen e kërkesave për pjesëmarrje: Data: **19/08/2019**, Ora: **10:00**; në ëëë.app.gov.al , në Agjencinë e Blerjeve të Përqendruara, Ministria e Brendshme, Sheshi “Skënderbej”, nr.3, Tiranë.

II. UDHËZIME PËR OPERATORËT EKONOMIKË

Seksioni 1 Hartimi i kërkesës /ofertës

- 1.1 Kandidatët/ofertuesit janë të detyruar të përgatisin kërkesat/ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Kërkesat/Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme.
- 1.2 Kandidatët/ofertuesit ngarkohet me kostot që lidhen me përgatitjen dhe dorëzimin e kërkesës/ofertës së tij. Autoriteti Kontraktor nuk është përgjegjës për këto kosto.
- 1.3 Për procedurat e prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, origjinali i kërkesës/ofertës duhet të shtypet ose të shkruhet me bojë që nuk fshihet. Të gjitha fletët e kërkesës/ofertes duhet të lidhen së bashku dhe të numerizohen. Të gjitha fletët e kërkesës/ofertës, përveç literaturës së pandryshueshme e të printuar duhet të pajisen me initiale ose të nënshkruhen nga Personi(-at) e autorizuar. Çdo ndryshim në kërkesë/ofertë duhet të jetë i lexueshëm dhe i firmosur nga Personat e Autorizuar.
- 1.4 Në rast të kërkesave/ofertave të paraqitura nga një bashkim i operatoreve ekonomike, oferta duhet të shoqërohet me Prokurën/autorizimin me shkrim për Personat e Autorizuar që do të përfaqësojnë bashkimin e operatoreve ekonomike gjatë procedurës së prokurimit.
- 1.5 Operatori ekonomik, mban përgjegjësi për të gjithë dokumentacionin e paraqitur si pjesë e ofertës. Në rast verifikimi të përmbajtjes së dokumentacionit të paraqitur, apo të vetëdeklarimeve, kur përmbajtja e tyre nuk rezulton e vërtetë, operatori ekonomik ndodhet në kushtet e parashikuara në nenin 13, pika 3, gërma (a) të LPP-së.

Seksioni 2. **Faza I - Parakualifikimi**

- 2.1 Paraqitja e kërkesave për pjesëmarrje duhet të bëhet brenda afatit përfundimtar të përcaktuar në Njoftimin e Kontratës.

Me plotesimin e Shtojcës “Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së Dispozitave Ligjore në Marrëdhëniet e Punës,, operatori ekonomik pranon se ka kontrata pune me çdo punëmarrës dhe që respekton të drejtat e punëmarrësve, sipas dispozitave të Kodit të Punës (ku përfshihen edhe të drejtat e gruas shtatzënë, gruas që sapo ka lindur dhe/ose gruas me fëmijë në gji, të parashikuara në nenet 104, 105, 105/a, 106, 108 dhe 115, dhe të legjislacionin të punës në tërësi.

Kërkesat e paraqitura pas skadimit të afatit përfundimtar do t’u kthehen të pahapura Kandidatëve.

- 2.2 Kërkesat duhet të dorëzohen në adresën e mëposhtme: [ëëë.app.gov.al](http://ee.app.gov.al)

Kur Kërkesa kërkohet të paraqitet me mjete elektronike, operatorët ekonomikë duhet ta dorëzojnë atë në faqen zyrtare të APP-së, [ëëë.app.gov.al](http://ee.app.gov.al).

- 2.3 Për procedurat e prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë vetëm kërkesën të futur në një zarf jotransparent, të mbyllur, të vulosur dhe firmosur me emrin dhe adresën e Kandidatit dhe të shënuar: “Kërkesë për parakualifikimin në procedurën Nr. Njoftimit__”

“MOS E HAPNI, ME PËRJASHTIM TË RASTEVE KUR ËSHTË I PRANISHËN KOMISIONI I VLERËSIMIT TË OFERTËS. DHE JO PARA _____ (dd/mm/vv), ora _____”.

Kur Kërkesa kërkohet të paraqitet me mjete elektronike, operatorët ekonomikë duhet ta dorëzojnë atë në faqen zyrtare të APP-së, ëëë.app.gov.al.

Seksioni 3. Faza II– Dorëzimi i Ofertave

3.1 Ofertat do të dorëzohen vetëm nga kandidatët të cilëve u është dërguar ftesa për ofertë nga Autoriteti Kontraktor, sipas modelit të dhënë në Shtojcën 2.

Kur oferta kërkohet të paraqitet me mjete elektronike, operatorët ekonomike duhet të dorëzojnë atë në faqen zyrtare të APP-së, ëëë.app.gov.al.

3.2 Oferta duhet të përfshijë dokumentat e mëposhtëm:

Dokumentacioni që duhet të paraqitet në Fazën II, nga kandidatët e kualifikuar në Fazën e I.

I. Oferta Ekonomike duhet të përfshijë dokumentat e mëposhtëm:

- 1) Formularin e Ofertës të plotësuar sipas Shtojcës 3 të DT.
- 2) Deklarata për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 3/1.

II. Oferta Teknike duhet të përfshijë dokumentat e mëposhtëm:

1. Ofertuesi duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga institucioni shtetëror ose faturat tatimore të realizuara me ente publike, ose fatura tatimore të shitjes të realizuara me subjekte private, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e hapjes së ofertave për fazën e dytë, me qëllim peshimin dhe vlerësimin me pikë të kapacitetit teknik në këtë fazë, për **furnizime të ngjashme për prodhimin dhe shpërndarjen e veshjeve dhe këpucëve të të njëjtës natyrë**. Furnizime të ngjashme për prodhimin dhe shpërndarjen e veshjeve dhe këpucëve të të njëjtës natyrë, për vlerësimin me pikë në fazën e dytë, do të konsiderohen: veshje dhe këpucë uniforme policie, ushtarake, garde, forca speciale, marine, etj.
2. Ofertuesi duhet të paraqesë **për numrin e deklaruar të fuqisë punëtore**, listëpagesat e deklarueshme të konfirmuara nga Administrata Tatimore sipas legjislacionit në fuqi, të 3 muajve të fundit nga data e hapjes së ofertave teknike.
3. Ofertuesi duhet të paraqesë **për personelin kryesor teknik të deklaruar** për zbatimin e objektit të prokurimit, **përsa i përket krijimit, zhvillimit, instalimit, mirëmbajtjes së sistemit elektronik të shpërndarjes** së uniformës dhe trajnimit për përdorimin e sistemit, dokumentacionin si vijon:
 - **Certifikatat MCSD, OCP ose ekuivalente, për programim .NET ose JAVA ose ekuivalente, të lëshuara nga prodhuesi i teknologjive dhe instrumentave që do përdoren për prodhimin e sistemit** për të paktën **2 (dy)** punonjës të cilët detyrimisht duhet të jenë të diplomuar për shkenca kompjuterike, informatikë ose elektronikë.
 - Certifikatat për programim MVC (model view controller) për të paktën **2 (dy)** persona të cilët detyrimisht duhet të jenë të diplomuar për shkenca kompjuterike, informatikë ose elektronikë.
 - Certifikatat për programim **EEB HTML5/CSS3/Javascript**, lëshuar nga një certifikues i njohur në nivel ndërkombëtar (psh: Microsoft, Oracle ose ekuivalente) për të paktën **2 (dy)** persona të cilët duhet të jenë detyrimisht të diplomuar për shkenca kompjuterike, informatikë ose elektronikë.
 - Certifikatat për përdorimin e bazave të të dhënave relacionale, lëshuar nga një certifikues i njohur në nivel

ndërkombëtar (psh: Microsoft, Oracle ose ekuivalente) për të paktën **2 (dy)** persona të cilët duhet të jenë detyrimisht të diplomuar për shkenca kompjuterike, informatikë ose elektronikë.

- Certifikatat për Testues Softëare për të paktën **1 (një)** person i cili duhet të jenë detyrimisht i diplomuar për shkenca kompjuterike, informatikë ose elektronikë.
- Certifikatat për PMP ose ekuivalente nga një institucion i njohur në nivel ndërkombëtar, që do të luajë rolin e menaxherit të projektit, për të paktën **1 (një)** person i cili duhet të jenë detyrimisht i diplomuar për shkenca kompjuterike, informatikë ose elektronikë.

Një individ mund të posedojë më shumë se një certifikatë nga certifikimet e mësipërme.

4. Ofertuesi duhet të paraqesë **për personelin kryesor teknik të deklaruar** për zbatimin e objektit të prokurimit, përsa i përket **prodhimit dhe shpërndarjes së artikulave të uniformës (veshje dhe këpucë)**, dokumentat: CV, diploma apo dëshmi të aftësive profesionale (nëse i zotërojnë), për :

- inxhinier tekstili, të paktën 1(një) punonjës
- kimist, të paktën 1(një) punonjës
- modelist për veshje, të paktën 1(një) punonjës
- modelist për këpucë, të paktën 1(një) punonjës
- përgjegjës prodhimi veshje, të paktën 1(një) punonjës
- përgjegjës prodhimi këpucë, të paktën 1(një) punonjës
- kontrollor cilësie veshje, të paktën 1(një) punonjës
- kontrollor cilësie këpucë, të paktën 1(një) punonjës
- specialist të lëkurës dhe këpucëve, të paktën 1(një) punonjës
- menaxher shpërndarje, të paktën 1(një) punonjës

5. Ofertuesi duhet të paraqesë dëshmi për mundësinë e ofrimit të sistemit elektronik të shpërndarjes së uniformës, sipas termave të referencës së sistemit të përcaktuara në Shtojcën 11 të dokumentave të tenderit.

Për të provuar mundësinë e ofrimit të sistemit elektronik të shpërndarjes së uniformës ofertuesi duhet të paraqesi **manualin e përdorimi të sistemit elektronik të shpërndarjes së uniformës** ku të jenë të pasqyruara kërkesat funksionale të sistemit, të shoqëruar me **linkun ku mund të aksesohet një demo e sistemit në internet**, së bashku me kredencialet e nevojshme (username dhe pasëord), me qëllim aksesimin dhe vlerësimin e tij nga autoriteti kontraktor.

Mos ofrimi i manualit të përdorimi të sistemit elektronik të shpërndarjes së uniformës dhe i linkut ku mund të aksesohet një demo e sistemit në internet së bashku me kredencialet e nevojshme (username dhe pasëord), është kusht për skualifikim.

6. Ofertuesi duhet të paraqesë një dokument që vërteton **marrëdhënie partneriteti të nivelit Gold ose ekuivalent**, me prodhuesin e teknologjive dhe instrumentave të përdorura për prodhimin e sistemit elektronik të ofruar (marrëveshje bashkëpunimi ose kontratë partneriteti ose cdo dokument tjetër që provon këtë marrëdhënie).

7. Ofertuesi duhet të jetë i çertifikuar sipas standardeve ndërkombëtare **ISO 22301** (të vlefshme) për sistemin e menaxhimit të vazhdimësisë së biznesit, në fushën e objektit të prokurimit.

8. Ofertuesi duhet të jetë i çertifikuar sipas standardeve ndërkombëtare **ISO 27001** (të vlefshme) për menaxhimin e sigurisë së informacionit.

9. Ofertuesi duhet të jetë i çertifikuar sipas standardeve ndërkombëtare **ISO 20000-1** (të vlefshme) për menaxhimin e shërbimit të teknologjisë së informacionit.

Çertifikatat të jenë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 74 të VKM 914 datë 29.12.2014, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punëve /mallrave /shërbimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas aktmarrëveshjes.

10. Ofertuesi duhet të paraqesë **certifikatë OEKO-TEX për tekstilet** dhe **certifikatë LEATHER by OEKO-TEX për lëkurën** (ose ekuivalente me to), të vlefshme, të prodhuesit të lëndës së parë. Në rastin kur lëndët e para sigurohen nga prodhues të ndryshëm, certifikata ose dokumenti ekuivalent me të, duhet të paraqitet për të gjithë prodhuesit. Në mungesë të certifikimit OEKO-TEX, pranohen raportet e testimit nga laboratorë të akredituar, të cilët vërtetojnë se lëndët e para nuk kanë substanca të dëmshme për shëndetin e njeriut dhe janë në përputhje me normativat e specifikuar të certifikimit OEKO-TEX.

11. **Certifikata konformiteti** për çdo model këpucë (aty ku kërkohet), sipas:

- EN ISO 20344-2011 dhe EN ISO 20347- 2012 O3 HRO HI CI ËR FO SRC ose ekuivalentet,
- EN ISO 20347- 2012 O2 HRO HI ËR FO SRC ose ekuivalentet,
- EN ISO 20347-2012 të modelit B - O2 CI ËR FO SRC ose ekuivalentet,
- EN ISO 20347-2012 të modelit A - O2 ËR FO SRC ose ekuivalentet,
- EN ISO 20347-2012 O2 ËR FO SRC ose ekuivalentet.

Pranohet edhe mundësia e paraqitjes së standardeve SSH/EN mbi konformitetin e standardeve europiane.

Certifikatat të jenë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 74 të VKM 914 date 29.12.2014, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punëve /mallrave /shërbimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas aktmarrëveshjes.

Certifikatat e konformitetit duhet të shoqërohet bashkë me të gjitha **testimet shoqëruese dhe me një deklaratë vërtetësie** nga enti që ka kryer analizat për certifikimin e artikullit. Deklarata duhet të përmbajë emërtimin e modelit të këpucës, logon e entit, kontaktet (telefon, email, faqe interneti), NIPT-in, adresën, emër mbiemër dhe firmën e përfaqësuesit ligjor me vulën e entit.

12. **Ofertuesi duhet të paraqesë:**

- Skedat teknike** të tekstilit, lëkurës, shollës, astarit të këpucëve, përforcueses së shollës, plastikës, metalit të përdorur për prodhimin e artikullit, e lëshuar nga prodhuesi i tij dhe e pajisur me logon, kontaktet (telefon, email, faqe interneti), NIPT-in, adresën, emër mbiemër dhe firmën e përfaqësuesit ligjor me vulën e kompanisë prodhuese përkatëse.
- Skeda teknike duhet të shoqërohet edhe me **një deklaratë vërtetësie nga laboratorit ku janë kryer testimet**. Laboratori duhet të jetë i akredituar sipas standardeve kombëtare / ndërkombëtare në fuqi.
- Deklaratë nga prodhuesi i aksesorëve** për përbërjen e materialeve të përdorura dhe cilësinë e tyre, sipas Specifikimeve Teknike, e konkretisht për: kopsat metalike (të mëdha, të vogla, xhemel), rripi i zi i kapelës, stema metalike dhe ornamentet e jakës, stema plastike, togëza metalike për rripat, kordona dekorativë për uniformën ceremoniale.
- Skeda teknike të produktit të gatshëm** (për gradat, shenjat, stemat) e lëshuar nga prodhuesi sipas provave laboratorike të përcaktuara në Specifikime Teknike.

13. Ofertuesi duhet të paraqesë si pjesë të ofertës teknike **mostrat / kampionet** e disa prej artikujve që kërkohen të prokurohen, të përcaktuar në tabelat si vijon.

Mosdorëzimi i mostrave / kampioneve përbën kusht për skualifikim.

I. KOSTUMET

Nr.	Emërtimi	Artikulli	Masa	Sasia e mostrave	Lënda e parë e mostrës	Dokumentacioni shoqërues
		pantallona	42	1 (një)	2 (dy)	- Skeda teknike të

1	Kostumi i uniformës për femra	xhaketa	42	1 (një)	kampione	tekstilit -Deklaratë vërtetësie nga Laboratori - Deklaratë nga prodhuesi për cilësinë e aksesorëve
		funde	42	1 (një)	tekstili me	
		kapele	54	1 (një)	përmasë	
2	Kostumi i uniformës për meshkuj	pantallona	54	1 (një)	0.5 m	linear, secili.
		xhaketa	54	1 (një)		
		kapele	57	1 (një)		
3	Kravata e kostumit të uniformës	kravata		1 (një)	2 (dy) kampione tekstili me përmasë 0.5 m linear, secili.	- Skeda teknike të tekstilit -Deklaratë vërtetësie nga Laboratori
4	Pantallona verore për meshkuj	pantallona	54	1 (një)	2 (dy) kampione tekstili me përmasë 0.5 m linear, secili.	- Skeda teknike të tekstilit -Deklaratë vërtetësie nga Laboratori
5	Fund veror për femra	fund	42	1 (një)	2 (dy) kampione tekstili me përmasë 0.5 m linear, secili.	- Skeda teknike të tekstilit -Deklaratë vërtetësie nga Laboratori
6	Kapela e uniformës verore për meshkuj dhe femra	kapele për meshkuj	57	1 (një)	2 (dy) kampione tekstili me përmasë 0.5 m linear, secili.	- Skeda teknike të tekstilit -Deklaratë vërtetësie nga Laboratori
		kapele për femra	54	1 (një)		
7	Kostumi i shërbimit civil për femra	xhaketa;	42	1 (një)	2 (dy) kampione	- Skeda teknike të tekstilit -Deklaratë vërtetësie nga Laboratori
		funde,	42	1 (një)	tekstili me	
		shalle		1 (një)	përmasë	
8	Kostumi i shërbimit civil për meshkuj	pantallona	54	1 (një)	0.5 m	linear, secili.
		xhaketa	54	1 (një)		

II. KËMISHAT

Nr.	Emërtimi	Artikulli	Masa	Sasia	Lënda e parë e mostrës	Dokumentacioni shoqërues
1	Këmishë bojëqielli me mëngë të gjata për femra	këmisha	42	1 (një)	2 (dy) kampione tekstili me përmasë 0.5 m linear, secili.	- Skeda teknike të tekstilit -Deklaratë vërtetësie nga Laboratori
2	Këmishë bojëqielli me mëngë të shkurtra për meshkuj	këmisha	41	1 (një)	2 (dy) kampione tekstili me	- Skeda teknike të tekstilit -Deklaratë vërtetësie
3	Këmisha ceremoniale me mëngë të gjata për meshkuj	këmisha	41	1 (një)	2 (dy) kampione tekstili me	- Skeda teknike të tekstilit -Deklaratë vërtetësie

4	<i>Këmishë me mëngë të shkurtra për femra në shërbimin civil</i>	këmisha	42	1 (një)	përmasë 0.5 m linear, secili.	nga Laboratori -Deklaratë nga prodhuesi për cilësinë e aksesorëve për kopsën xhemel
---	---	---------	----	---------	-------------------------------	--

III. ARTIKUJ ME MATERIALE DOKU (RIPSTOP)

Nr.	Emërtimi	Artikulli	Masa	Sasia	Lënda e parë e mostrës	Dokumentacioni shoqërues
1	<i>Kostumi taktik</i>	Këmishë dhe pantallona	M	1 (një)	2 (dy) kampione tekstili me përmasë 0.5 m linear, secili.	- Skeda teknike të tekstilit -Deklaratë vërtetësie nga Laboratori - Deklaratë nga prodhuesi për cilësinë e aksesorëve për stemën plastike
2	<i>Kapele sportive</i>	Kapele	M	1 (një)		
3	<i>Këmishë blu me mëngë të shkurtra</i>	Këmishë	M	1 (një)		
4	<i>Pantallona doku verore</i>	Pantallona për femra	44	1 (një)		
		Pantallona për meshkuj për motoçiklistë	52	1 (një)		
5	<i>Pantallona të shkurtra</i>	Pantallona për femra	44	1 (një)		
		Pantallona për meshkuj	52	1 (një)		

IV. ARTIKUJ ME MATERIAL TRIKOTAZH

Nr.	Emërtimi	Artikulli	Masa	Sasia	Lënda e parë e mostrës	Dokumentacioni shoqërues
1	<i>Bluzë pambuku me mëngë të gjata me jakë rrumbullake</i>	Bluza për meshkuj.	M	1 (një)	2 (dy) kampione tekstili me përmasë 0.5 m linear, secili.	- Skeda teknike të tekstilit -Deklaratë vërtetësie nga Laboratori
2	<i>Bluzë pambuku me mëngë të shkurtra me jakë rrumbullake</i>	bluza për femra.	M	1 (një)		
3	<i>Bluzë polo me mëngë të shkurtra për punonjësit e Policisë së Shtetit</i>	bluza për meshkuj.	M	1 (një)	2 (dy) kampione tekstili me përmasë 0.5 m linear, secili.	- Skeda teknike të tekstilit -Deklaratë vërtetësie nga Laboratori
4	<i>Bluzë polo me mëngë të gjata për patrullat e Policisë së Shtetit</i>	bluza për meshkuj.	M	1 (një)		
		bluza për femra.	M	1 (një)		
5	<i>Bluzë polo me mëngë të shkurtra për patrullat e Policisë së Shtetit</i>	bluza për meshkuj.	M	1 (një)		
		bluza për femra.	M	1 (një)		
6	<i>Bluzë me mëngë të shkurtra për punonjësit me shërbim pranë plazheve</i>	bluza për meshkuj.	M	1 (një)	2 (dy) kampione tekstili me përmasë 0.5 m linear,	- Skeda teknike të tekstilit -Deklaratë vërtetësie nga Laboratori
		bluza për femra.	M	1 (një)		

“Blerje dhe shpërndarje e uniformave dhe këpucëve të Policisë së Shtetit”

					secili.	
7	Pulovër i trikotuar me jakë "V"	Pulovra për meshkuj.	M	1 (një)	2 (dy) pjesë tekstili të trikotuar me përmasë 0.5 x 0.5 m, i punuar me dy llojet e thurjeve për punimin e pulovrit, llastik 1:1 dhe interlock.	- Skeda teknike të tekstilit -Deklaratë vërtetësie nga Laboratori
		Pulovra për femra.	M	1 (një)		
8	Pulovër i trikotuar me jakë rrumbullake	Pulovra për meshkuj.	M	1 (një)		
		Pulovra për meshkuj.	M	1 (një)		
9	Pulovër me jakë gjysëm golf	Pulovra për meshkuj.	M	1 (një)		
		Pulovra për meshkuj.	M	1 (një)		
10	Kapuç leshi	kapuç	M	1 (një)		

V. XHUPA

Nr.	Emërtimi	Artikulli	Masa	Sasia	Lënda e parë e mostrës	Dokumentacioni shoqërues
1	Khup i shkurtër	Khup për meshkuj	M	1 (një)	2 (dy) kampione tekstili me përmasë 0.5 m linear, secili.	- Skeda teknike të tekstilit -Deklaratë vërtetësie nga Laboratori
		Khup për femra	M	1 (një)		
2	Khup treçereksh	Khup për meshkuj	M	1 (një)		
		Khup për femra	M	1 (një)		
3	Kostumi dimëror për motoçiklistët	Pantallona për meshkuj	54	1 (një)	2 (dy) kampione tekstili me përmasë 0.5 m linear, secili.	- Skeda teknike të tekstilit -Deklaratë vërtetësie nga Laboratori
		Khup për meshkuj	54	1 (një)		
4	Kostumi dimëror për patrullat	Pantallona për femra	42	1 (një)		- Deklaratë nga prodhuesi për cilësinë e aksesorëve për stemën plastike
		Khup për femra	42	1 (një)		
5	Kapele sportive dimërore	kapele	M	1 (një)		
6	Dorashka motoçiklisti	dorashka për meshkuj	M	1 (një)	2 (dy) kampione tekstili me përmasë 0.5 m linear, secili.	- Skeda teknike të tekstilit -Deklaratë vërtetësie nga Laboratori
		dorashka për femra	M	1 (një)		
8	Khup me vizibilitet të lartë	Khup për meshkuj	M	1 (një)	2 (dy) kampione tekstili me përmasë 0.5 m linear, secili.	- Skeda teknike të tekstilit -Deklaratë vërtetësie nga Laboratori
		Khup për femra	M	1 (një)		
9	Mushama shiu	Mushama	M	1 (një)	2 (dy) kampione tekstili me përmasë 0.5 m linear, secili.	- Skeda teknike të tekstilit -Deklaratë vërtetësie nga Laboratori

VI. AKSESORË

Nr.	Emërtimi	Artikulli	Masa	Sasia	Lënda e parë e mostrës	Dokumentacioni shoqërues
1	Aksesorë reflektivë	jelekë blu	M	1 (një)	2 (dy) kampione tekstili me përmasë 0.5 m linear, secili.	- Skeda teknike të tekstilit -Deklaratë vërtetësie nga Laboratori
		jelekë të gjelbër	M	1 (një)		
		jelekë të kuq	M	1 (një)		
		mbulesa për kapelen e uniformës për meshkuj	2	1 (një)	2 (dy) kampione tekstili me përmasë 0.5 m linear, secili.	- Skeda teknike të tekstilit -Deklaratë vërtetësie nga Laboratori
		mbulesa për kapelen e uniformës për femra	2	1 (një)		
		mëngore	(masë unike)	1 (një)		
2	Dorashka ceremoniale	dorashka ceremoniale për meshkuj	M	1 (një)	2 (dy) kampione tekstili me përmasë 0.5 m linear, secili.	- Skeda teknike të tekstilit -Deklaratë vërtetësie nga Laboratori
		dorashka ceremoniale për femra	M	1 (një)		
3	Dorashka prej lëkure	dorashka për meshkuj	M	1 (një)	2 (dy) kampione të lëkurës meshinë deleje 30 x 30 cm, secili.	- Skeda teknike të lëkurës -Deklaratë vërtetësie nga Laboratori
		dorashka për femra	M	1 (një)		
4	Jelek operacional multifunksional	jelekë	I	1 (një)	2 (dy) kampione tekstili me përmasë 0.5 m linear, secili.	- Skeda teknike të tekstilit -Deklaratë vërtetësie nga Laboratori
5	Jelek shpëtimi	jelekë	M	1 (një)	2 (dy) kampione tekstili me përmasë 0.5 m linear, secili.	- Skeda teknike të tekstilit -Deklaratë vërtetësie nga Laboratori
6	Jelek prezantues	jelekë	I	1 (një)	2 (dy) kampione tekstili me përmasë 0.5 m linear, secili.	- Skeda teknike të tekstilit -Deklaratë vërtetësie nga Laboratori

7	Rrip për uniformën ceremoniale	rrip	M	1 (një)	2 (dy) kampione telatinë natyrale 30 x 30 cm	- Skeda teknike të lëkurës -Deklaratë vërtetësie nga Laboratori - Deklaratë nga prodhuesi për cilësinë e aksesorëve
8	Rripi operacional multifunksional	rrip	II	1 (një)	2 (dy) kampione tekstili me përmasë 0.5 m linear,	- Skeda teknike të tekstilit -Deklaratë vërtetësie nga Laboratori
9	Rripi i pantallonave	rripa pantallonash për meshkujt	M	1 (një)	2 (dy) kampione telatinë natyrale 30 x 30 cm	- Skeda teknike të lëkurës -Deklaratë vërtetësie nga Laboratori -Deklaratë nga prodhuesi për cilësinë e aksesorëve
		rripa pantallonash për femra	M	1 (një)		

VII. KËPUCË

Nr.	Emërtimi	Artikulli	Masa	Sasia	Lënda e parë e mostrës	Dokumentacioni shoqërues
1	Këpucë taktike me qafë, verore për punonjësit e Policisë së Shtetit.	këpucë për meshkuj	42	1 (një) palë	2 (dy) pjesë të lëkurës së përdorur për ndërtimin e këpucës 30 x 30 cm	-Çertifikatë konformiteti për këpucën, bashkë me të gjitha testimet shoqëruese, sipas EN ISO 20344-2011 dhe EN ISO 20347-2012 O3 HRO HI CI ËR FO SRC ose ekuivalentet. - Deklaratë vërtetësie nga enti që ka kryer analizat për çertifikimin e artikullit. -Skedat teknike të lëkurës dhe shollës -Skeda teknike e tekstilit -Deklaratë vërtetësie nga Laboratori.
		këpucë për femra	38	1 (një) palë	2 (dy) copë tekstil teknik të përdorur për ndërtimin e këpucës 0.5 m	
	Këpucë taktike me qafë, dimërore, për punonjësit e Policisë së Shtetit.	këpucë për meshkuj	42	1 (një) palë	2 (dy) pjesë të lëkurës së përdorur për ndërtimin e këpucës 30 x 30 cm	-Çertifikatë konformiteti për këpucën, bashkë me të gjitha testimet shoqëruese, sipas EN ISO 20344-2011 dhe EN ISO 20347-2012 O3 HRO HI

“Blerje dhe shpërndarje e uniformave dhe këpucëve të Policisë së Shtetit”

2		këpucë për femra	38	1 (një) palë		CI ËR FO SRC ose ekuivalentet. - Deklaratë vërtetësie nga enti që ka kryer analizat për çertifikimin e artikullit. -Skedat teknike të lëkurës dhe shollës -Deklaratë vërtetësie nga Laboratori.
3	<i>Këpucë taktike me qafë të shkurtër, verore, për strukturat e veçanta.</i>	këpucë për meshkuj	42	1 (një) palë	2 (dy) pjesë të lëkurës së përdorur për ndërtimin e këpucës 30 x 30 cm	-Çertifikatë konformiteti për këpucën, bashkë me të gjitha testimet shoqëruese, sipas EN ISO 20344-2011 dhe EN ISO 20347-2012 O3 HRO HI CI ËR FO SRC ose ekuivalentet. - Deklaratë vërtetësie nga enti që ka kryer analizat për çertifikimin e artikullit. -Skedat teknike të lëkurës dhe shollës -Skeda teknike e tekstilit -Deklaratë vërtetësie nga Laboratori
		këpucë për femra	38	1 (një) palë	2 (dy) copë tekstil teknik të përdorur për ndërtimin e këpucës 0.5 m	- Deklaratë vërtetësie nga enti që ka kryer analizat për çertifikimin e artikullit. -Skedat teknike të lëkurës dhe shollës -Skeda teknike e tekstilit -Deklaratë vërtetësie nga Laboratori
4	<i>Këpucë taktike, verore, për punonjësit e Policisë së Shtetit me shërbim në plazhe.</i>	këpucë për meshkuj	42	1 (një) palë	2 (dy) pjesë të lëkurës së përdorur për ndërtimin e këpucës 30 x 30 cm	- Çertifikatë konformiteti për këpucën, bashkë me të gjitha testimet shoqëruese, sipas EN ISO 20347-2012 O2 HRO HI ËR FO SRC ose ekuivalentet. - Deklaratë vërtetësie nga enti që ka kryer analizat për çertifikimin e artikullit. -Skedat teknike të lëkurës dhe shollës -Skeda teknike e tekstilit -Deklaratë vërtetësie nga Laboratori
		këpucë për femra	38	1 (një) palë	2 (dy) copë tekstil teknik të përdorur për ndërtimin e këpucës 0.5 m	- Deklaratë vërtetësie nga enti që ka kryer analizat për çertifikimin e artikullit. -Skedat teknike të lëkurës dhe shollës -Skeda teknike e tekstilit -Deklaratë vërtetësie nga Laboratori
	<i>Këpucë dimërore për</i>	këpucë për meshkuj	42	1 (një) palë	2 (dy) pjesë të lëkurës së përdorur për	- Çertifikatë konformiteti për këpucën, bashkë me

"Blerje dhe shpërndarje e uniformave dhe këpucëve të Policisë së Shtetit"

5	<i>për punonjësit e Policisë së Shtetit</i>	këpucë për femra	38	1 (një) palë	ndërtimin e këpucës 30 x 30 cm	të gjitha testimet shoqëruese, sipas EN ISO 20347-2012 të modelit B - O2 CI ËR FO SRC ose ekuivalentet. - Deklaratë vërtetësie nga enti që ka kryer analizat për çertifikimin e artikullit. -Skedat teknike të lëkurës dhe shollës -Deklaratë vërtetësie nga Laboratori.
6	<i>Këpucë verore për meshkuj për punonjësit e Policisë së Shtetit</i>	këpucë për meshkuj	42	1 (një) palë	2 (dy) pjesë të lëkurës së përdorur për ndërtimin e këpucës 30 x 30 cm	- Çertifikatë konformiteti për këpucën, bashkë me të gjitha testimet shoqëruese, sipas EN ISO 20347-2012 të modelit A - O2 ËR FO SRC ose ekuivalentet. -Deklaratë vërtetësie nga enti që ka kryer analizat për çertifikimin e artikullit. -Skedat teknike të lëkurës dhe shollës -Deklaratë vërtetësie nga Laboratori
7	<i>Këpucë verore për femra për punonjëset e Policisë së Shtetit</i>	këpucë për femra	38	1 (një) palë	2 (dy) pjesë të lëkurës së përdorur për ndërtimin e këpucës 30 x 30 cm	- Çertifikatë konformiteti për këpucën, bashkë me të gjitha testimet shoqëruese, sipas EN ISO 20347-2012 O2 ËR FO SRC ose ekuivalentet. -Deklaratë vërtetësie nga enti që ka kryer analizat për çertifikimin e artikullit. -Skedat teknike të lëkurës dhe shollës -Deklaratë vërtetësie nga Laboratori

8	<i>Këpucë ceremoniale për meshkuj për punonjësit e Policisë së Shtetit</i>	këpucë për meshkuj	42	1 (një) palë	2 (dy) pjesë të lëkurës së përdorur për ndërtimin e këpucës 30 x 30 cm	-Skedat teknike të lëkurës dhe shollës -Deklaratë vërtetësie nga Laboratori
9	<i>Këpucë ceremoniale për femra për punonjëset e Policisë së Shtetit</i>	këpucë për femra	38	1 (një) palë	2 (dy) pjesë të lëkurës së përdorur për ndërtimin e këpucës 30 x 30 cm 2 (dy) pjesë të astarit të përdorur për ndërtimin e këpucës 30 x 30 cm	-Skedat teknike të lëkurës, astarit, shollës dhe përforcueses së shollës. -Deklaratë vërtetësie nga Laboratori

VIII. GRADAT, STEMAT DHE KORDONAT

Nr.	Emërtimi	Artikulli	Rangu	Sasia	Lënda e parë e mostrës	Dokumentacioni shoqëruar
1	<i>"Gradat e mëdha të shërbimit të Policisë së Shtetit"</i>	Grada të mëdha shërbimi	- Inspektor i parë - Kryekomisar - Drejtues - Drejtues i lartë	Një palë për secilin rang.	2 (dy) kampione tekstili me përmasë 0.5 m linear në gjerësinë e tekstit, secili.	-Skeda teknike të tekstit -Skeda teknike të elementëve plastikë -Deklaratë vërtetësie nga Laboratori
2	<i>"Gradat e vogla të gjoksit, Numri i Identifikimit dhe Shenja e Mbiemrit"</i>	Grada të vogla gjoksi numri i identifikimit shenja e mbiemrit	- Inspektor - Nënkomisar - Drejtues i parë - Drejtues Madhor	Një copë për secilin rang. 1 (një) 1 (një)		-Skeda teknike të elementëve metalikë -Deklaratë vërtetësie nga Laboratori -Skeda teknike të secilit produkt të gatshëm (Grada Shërbimi, Grada Gjoksi, Grada Ceremoniale).
3	<i>"Gradat e mëdha Ceremoniale të Policisë së Shtetit"</i>	Grada të mëdha ceremoniale	- Inspektor i dytë - Komisar - Drejtues - Drejtues Madhor	Një palë për secilin rang.		
4	<i>"Stema e Policisë dhe shenjat dalluese të krahut për punonjësit e Policisë së Shtetit"</i>	Stema të Policisë së Shtetit Logo të Policisë së Shtetit Shenja sipas çdo shërbimi të Policisë së Shtetit		1 (një) 1 (një) 1 (një) copë për çdo shenjë		-Skeda teknike të plastikës -Skeda teknike të produktit të gatshëm -Deklaratë vërtetësie nga Laboratori

"Blerje dhe shpërndarje e uniformave dhe këpucëve të Policisë së Shtetit"

			POLICIA KUFITARE			
5	Kordonë dekorativë	kordonë ceremoniale për kapelën.	Drejtues–Drejtues Madhor	1 (një) copë	1 (një) pjesë me gjatësi 50 cm nga secili shirit që është përdorur për realizimin e kordonëve	-Skeda teknike të kordonave -Deklaratë vërtetësie nga Laboratori -Deklaratë nga prodhuesi për cilësinë e aksesorëve
		kordonë ceremoniale, për supin		1 (një) copë		
		kordonë ceremoniale për kapelën.	Reparti Ceremonial dhe Trupa	1 (një) copë		
		kordonë ceremoniale, për supin		1 (një) copë		
		kordonë ceremoniale për kapelën.	Strukturat e Sigurisë Publike në Policinë e Shtetit (me ngjyrë bojëqielli).	1 (një) copë		
		kordonë ceremoniale, për supin		1 (një) copë		

Mënyra e dorëzimit të mostrave

Secili prej artikujve të sipërcituar, duhet të dorëzohet në një kampion/ mostër. Kampioni / mostra duhet të jetë e qepur me fije me ngjyrën e artikullit. Artikujt duhet të kenë të qepur/ montuar të gjithë aksesorët, sipas specifikimeve teknike.

Kampionet/ mostrat duhet të kenë të qepur etiketën origjinale të fabrikës ku janë prodhuar dhe të jenë me ambalazhim fabrike.

Kampionet / mostrat duhet të jenë lehtësisht të identifikueshme me numrin rendor përkatës, të fiksuar në artikull dhe të vulosur nga ofertuesi, sipas numrit rendor të tabelave të mësipërme (psh: VII/ 9 - për këpucë ceremoniale për femra për punonjëset e Policisë së Shtetit),

dh) (Opsion) ofertën alternative teknike (nëse parashikohet)

Një Ofertues duhet të paraqesë vetëm një ofertë.

3.3 Fshehtësia e procesit sipas nenit 25 të LPP-së.

3.4 Për procedurat e prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, ofertuesit duhet të dorëzojnë ofertën origjinale të futur në një zarf jotransparent, të mbyllur, të vulosur dhe firmosur me emrin dhe adresën e Ofertuesit dhe të shënuar: “Ofertë për furnizimin e _____ mallrave; Nr. Njoftimit _____

“MOS E HAPNI, ME PËRJASHTIM TË RASTEVE KUR ËSHTË I PRANISHËN KOMISIONI I VLERËSIMIT TË OFERTËS DHE JO MË PARË SE _____ (dd/mm/vv), ora _____”.

Kur oferta kërkohet të paraqitet me mjete elektronike, operatorët ekonomike duhet të dorëzojnë ofertën në mënyrë elektronike në faqen zyrtare të APP-së, eeë.app.gov.al

3.5 Për procedurat e prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, ofertuesit mund të modifikojnë ose të tërheqin ofertat e tyre, me kusht që ky modifikim ose tërheqje të kryhet para afatit kohor përfundimtar për paraqitjen e ofertave. Si modifikimet, ashtu edhe tërheqjet duhet t'i komunikohen Autoritetit Kontraktor me shkrim para datës së fundit për dorëzimin e ofertave. Rrjedhimisht, zarfi që përmban deklaratën e Ofertuesit duhet të

shënohet përkatësisht: “**MODIFIKIM OFERTE**” ose “**TËRHEQJE OFERTE**”.

Kur oferta kërkohet të paraqitet me mjete elektronike, ofertuesi mund të modifikojë në çdo kohë ofertën deri para afatit kohor përfundimtar për dorëzimin e ofertave pa patur nevojë për ndonjë komunikim me autoritetin kontraktor, pasi veprimet kryhen në llogarinë e tij, në faqen zyrtare të APP-së.

Seksioni 4 Përlllogaritja e ofertës ekonomike

- 4.1 Operatori Ekonomik duhet të plotësojë Formularin e Ofertës Ekonomike bashkangjitur me këto DT, duke përcaktuar mallrat që do të furnizohen, sasitë dhe çmimin e tyre.
- 4.2 Të gjitha çmimet duhet të kuotohen në Monedhën Shqiptare (Lek), duke përfshirë edhe tatimet që zbatohen por pa përfshirë TVSH-në. Nëse çmimet kuotohen në një monedhë të huaj, atëherë ato duhet të kthehen në Lekë Shqiptare sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, në datën në të cilën është dërguar për publikim njoftimi i kontratës dhe duhet të ruhen në atë kurs deri në skadimin e periudhës së vlefshmërisë së ofertës.
- 4.3 Ofertuesi duhet të shënojë në Formularin e Ofertes Ekonomike çmimet totale të ofertës të të gjitha mallrave, pa TVSH. Vlera e TVSH-së, kur aplikohet, i shtohet çmimit të dhënë dhe përbën vlerën totale të ofertës.
- 4.4 Në rastin e një marrëveshje kuadër ku të gjitha kushtet NUK janë përcaktuar Çmimet për kontratat e bazuara në marrëveshjen kuadër nuk janë të fiksuara; ato janë objekt i ndryshimit pas një Mini-konkursi në mes të palëve në marrëveshjen kuadër.
- 4.5 Sigurimi i Ofertës, kur kërkohet, duhet të dorëzohet bashkë me Ofertën para skadimit të afatit kohor për dorëzimin e ofertave. Mospajtimi me kërkesat për sigurimin e ofertës do të ketë si pasojë refuzimin e ofertës.
- 4.6 Sigurimi i Ofertës mund të dorëzohet në një nga format e mëposhtme:
 - a) garanci bankare
 - b) garanci sigurimi

Formulari i sigurimit të ofertës duhet të nënshkruhet nga lëshuesi (Banka, kompania e sigurimit, etj) dhe duhet të dorëzohet së bashku me ofertën para hapjes së ofertave, përndryshe oferta do të refuzohet.

Dokumentat si më sipër duhet të jenë të vlefshëm përgjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së ofertës. Në rastin kur sigurimi i ofertës ka formën e një garancie bankare, Autoriteti Kontraktor ia rikthen ofertuesve sigurimin përkatës brenda 15 ditëve nga nënshkrimi i kontratës.

4.7 Periudha e Vlefshmërisë së Ofertës

Periudha e vlefshmërisë së ofertës fillon që nga momenti i hapjes së ofertave. Në çdo rast, të paktën 5 ditë nga përpara përfundimit të afatit kohor për vlefshëmrinë e ofertave, autoriteti kontraktor mund t'i kërkojë Ofertuesit me shkrim të zgjasë periudhën e vlefshmërisë, deri në një datë të caktuar. Ofertuesi mund t'a refuzojë këtë kërkesë me shkrim pa humbur të drejtën për rimbursim të sigurimit të ofertës, kur ka një tillë. Ofertuesi që bie dakord të zgjasë periudhën e vlefshmërisë së ofertës njofton Autoritetin Kontraktor me shkrim, dhe paraqet një sigurim oferte të zgjatur, nëse ka pasur një të tillë. Oferta nuk mund të modifikohet. Nëse Ofertuesi nuk i përgjigjet kërkesës së bërë nga Autoriteti Kontraktor lidhur me zgjatjen e periudhës së vlefshmërisë së ofertës, ose nuk e pranon kërkesën në fjalë, ose nuk paraqet një sigurim të zgjatur të ofertës, kur kërkohet, atëherë Autoriteti Kontraktor do të refuzojë ofertën.

4.8 Veprimet e jashtëligjshme sipas Nenit 26 të LPP-së.

Seksioni 5. Vlerësimi i Ofertave

Kriteret e përzgjedhjes

- 5.1 **(Opsioni 1)** Çmimi më i ulët i ofertës së kualifikuar
Kontrata do t'i akordohet atij Ofertuesi që ka ofruar çmimin më ulët të ofertës së kualifikuar.

(Opsioni 2)

Oferta ekonomikisht më e favorshme.

Për kriteret vlerësuese duhet përcaktuar qartë pesha specifike e secilit kriter dmth sa pikë do të ketë cdo kriter dhe si do të llogariten pikët për ofertuesit e njëpasnjëshëm. Të gjitha kriteret vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. **Në cdo rast kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të cmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100.**

Formula me të cilën do të llogariten pikët e ofertuesve në këtë rast është:

$$Po = Pk1 + Pk2 + Pk3 + \dots$$

Ku:

Po - janë pikët totale të ofertës së vlerësuar

Pk1/Pk2/Pk3/... - janë pikët për cdo kriter të vlerësuar

Pikët për cdo kriter përlllogariten sipas formulës:

$$Pk1 = V_{min} k1 \times P_{max} k1 / O_{k1}$$

Pk1 _____ Pikët e kriterit që vlerësohet

V_{min} k1 _____ Vlera e më e ulët e kriterit që vlerësohet

P_{max} k1 _____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k1} _____ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Sqarim: Si kriter vlerësimi duhet të përzgjidhet vetëm njërin prej opsioneve. Plotësimi i të dy opsioneve e bën procedurën të pavlefshme.

5.2 **Korrigjimi i gabimeve dhe pjesët e hequra**

- 5.2.1 Autoriteti Kontraktor korrigjon ato gabime në ofertë, që janë thjesht të një natyre aritmetike, nëse gabimi zbulohet gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti Kontraktor e njofton menjëherë Ofertuesin në fjalë me një njoftim me shkrim/elektronik mbi çdo korrigjim të tillë dhe mund të vazhdojë me ndryshimin e gabimit, me kusht që Ofertuesi t'a ketë miratuar këtë komunikim që i është bërë. Nëse Ofertuesi refuzon të pranojë korrigjimin e propozuar, atëherë oferta do të refuzohet, pa konfiskim të sigurimit të ofertës, nëse ekziston një e tillë.

- 5.2.2 Gabimet në llogaritjen e çmimit do të korrigjohen nga Autoriteti Kontraktor, sipas shëmbujve të mëposhtme:

- në rast se ka mospërputhje ndërmjet shumave të shprehura në shifra dhe atyre në fjalë, atëherë do të mbizotërojnë shumat e shprehura në fjalë, me përjashtim të rasteve kur shumat në fjalë lidhet me një gabim aritmetik;
- nëse ka mospërputhje ndërmjet çmimit njësi dhe vlerës së përgjithshme që merret nga shumëzimi i çmimit njësi dhe sasisë, atëherë do të mbizotërojë çmimi njësi, dhe rrjedhimisht duhet të korrigjohet shumat në total, nëse ka një gabim në një shumë total, që korrespondon me mbledhjen ose zbritjen e nëntotaleve, atëherë do

të mbizotërojë nëntotali dhe totali duhet të korrigjohet. Shumat e korrigjuara në këtë mënyrë janë të detyrueshme për ofertuesin. Nëse ofertuesi nuk i pranon ato, atëherë oferta e tij do të refuzohet *Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se $\pm 2\%$ e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar*.

5.3 Ofertat anomalisht të ulëta

5.3.1 Nëse oferta e dorëzuar, rezulton anomalisht e ulët në lidhje me mallrat e ofruara, atëherë Autoriteti Kontraktor i kërkon Ofertuesit në fjalë të justifikojë çmimin e ofruar. Nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim që të bindë Autoritetin Kontraktor, atëherë ky i fundit ka të drejtë të refuzojë ofertën.

5.3.2 Oferta do të cilësohet anomalisht e ulët sipas përcaktimit të bërë në nenin 66 të Kreut VII të RrPP.
Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 56, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25 përqind e fondit limit të përlogaritur.
Në rastin kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85 përqind e mesatares së ofertave të vlefshme.

Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP.

Në çdo rast ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe dokumentojë me prova shkresore sqarimet mbi elementin/elementët e veçantë të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP.

Formula që do të zbatohet për të cilësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ka tre ose më shumë oferta të vlefshme është si më poshtë:

O – Oferta
 M_O – Mesatarja e Ofertave të vlefshme
n – Numri i Ofertave të vlefshme
 Z_M – Zbritja e Mundshme

$$M_O = O_1 + O_2 + O_3 + \dots O_n / n$$

$$Z_M = 85 \% M_O$$

Vlera e Ofertës që vlerësohet $< Z_M$, si rrjedhim Oferta është Anomalisht e Ulët

Në rastin kur kriter vlerësimi është përzgjedhur oferta ekonomikisht më e favorshme, do të verifikohet nëse ofertat janë anomalisht të ulëta vetëm nëse oferta e klasifikuar me piket më të larta e ka ofertën ekonomike me vlerën më të ulët..

5.4. Ankimi administrativ në dispozicion të Operatorëve Ekonomikë sipas nenit 63 të LPP-së.

Seksioni 6 Nënshkrimi i Kontratës

6.1 Njoftimi i fituesit

Autoriteti Kontraktor njofton Ofertuesin fitues, përmes dërgimit të njoftimit të fituesit, siç parashikohet në Shtojcën 15. Një kopje e këtij njoftimi publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike, siç kërkohet në Nenin 58 të LPP-së.

6.2 Sigurimi i kontratës

6.2.1 Autoriteti Kontraktor kërkon sigurim për ekzekutimin e kontratës. Shuma e sigurimit për ekzekutimin e kontratës do të jetë 10 % e vlerës së kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, sipas Shtojcës 21 të DT, duhet të nënshkruhet dhe të dorëzohet para nënshkrimit të kontratës.

6.2.2 Sigurimi për ekzekutimin e kontratës mund të dorëzohet në një nga format e mëposhtme:

- i. garanci bankare
- ii. garanci sigurimi

Ky formular nuk përdoret nga autoritetet kontraktore në rastin e prokurimit të kontratave sektoriale.

6.3 Njoftimi i kontratës së nënshkruar

Në pajtim me RrPP, pas nënshkrimit të kontratës, autoriteti kontraktor dërgon një njoftim në APP për publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike.

Shënim: Autoritetet kontraktore nuk duhet të ndërhyjnë për të bërë asnjë lloj ndryshimi në dokumentat e tenderit nga pika 1 në pikën 6.

III. SHTOJCAT

Shtojcat e mëposhtme janë pjesë përbërëse e DT:

- Shtojca 1: Formulari i Kërkesës për shprehje interesi
- Shtojca 2: Ftesa për Ofertë
- Shtojca 3: Formulari i Ofertës
- Shtojca 3/1: Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur
- Shtojca 4: Ftesa për Ofertë në rastin e Marrëveshjes Kuadër
- Shtojca 5: Formulari i Sigurimit të Ofertës
- Shtojca 6: Formulari i Informacionit Konfidencial
- Shtojca 7: Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike
- Shtojca 8: Deklarata për konfliktin e interesit
- Shtojca 9: Deklarata mbi përmbushjen kritereve të përgjithshme
- Shtojca 9/1: Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës
- Shtojca 10: Formular për Vërtetimin e Kualifikimit/pjesëmarrjes
- Shtojca 11: Specifikimet teknike
- Shtojca 12: Planifikimi i kontratave në marrëveshjen kuadër
- Shtojca 13: Sasia dhe grafiku i lëvrimit
- Shtojca 14: Njoftim Standard për Kandidatin/Ofertuesin e S'kualifikuar
- Shtojca 15: Formulari i njoftimit të fituesit
- Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të operatorëve ekonomikë të suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër
- Shtojca 17: Kushtet e Përgjithshme të Kontratës
- Shtojca 18: Kushtet e Vecanta të Kontratës
- Shtojca 19: Formulari i njoftimit të Kontratës së nënshkruar
- Shtojca 20: Formulari i Njoftimit të Kontratës së Nënshkruar për publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike
- Shtojca 21: Formulari i Sigurimit të Kontratës
- Shtojca 22: Formulari i Ankesës në Autoritetin Kontraktor
- Shtojca 23: Draft Marrëveshja Kuadër ku Jo të gjitha kushtet janë të përcaktuara
- Shtojca 24: Draft Marrëveshja Kuadër ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara
- Shtojca 25: Formulari i njoftimit të anulimit

Shtojca 1

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

FORMULARI I KËRKESËS PËR PJESËMARRJE

Emri i Ofertuesit _____

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

* * *

Procedura e prokurimit: [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr.Referencës në faqen e APP-se

* * *

Ne, të nënshkruarit, paraqesim kërkesën tonë për të marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi [jepni detaje të objektit të kontratës sic përcaktohet në Dokumentat të Tenderit].

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi i ofertuesit

Vula

Shtojca 2

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FTESË PËR OFERTË

(Vetëm për kandidatët e përzgjedhur në fazën e parë)

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të përzgjedhur]

Procedura e Prokurimit: [lloji dhe objekti i procedurës]

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, ju informojmë se [emri dhe adresa e kandidatit të përzgjedhur], pas vlerësimit të kapaciteteve tuaja ligjore, financiaro-ekonomike dhe teknike, Jeni kualifikuar për në fazën e ofertimit në këtë procedurë.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [këtij autoriteti kontraktor]

Emri _____

Adresa _____

ofertën tuaj, duke marrë parasysh se:

Afati kohor për dorëzimin e ofertave është:

Data // (dd/mm/vvvv)

Ora: _____

Adresa _____

Kur oferta kërkohet të paraqitet me mjete elektronike operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë ofertën në faqen zyrtare të APP-së, [ëëë.app.gov.al](http://ee.app.gov.al).

Afati kohor për hapjen e ofertave është:

Data // (dd/mm/vvvv)

Ora: _____

Adresa _____

Informacioni mbi ofertat e paraqitura me mjete elektronike duhet t'i komunikohet të gjithë operatorëve ekonomikë që kanë dorëzuar oferta, në bazë të kërkesës së tyre.

Gjuha(-ët) për hartimin e ofertës janë:

Shqip

Anglisht

Tjetër _____

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit janë

A) Çmimi më i ulët

ose

B) Oferta ekonomikisht më e favorshme

(kriteret siç paraqiten në dokumentat e tenderit)

Jemi në pritje të ofertës suaj.

[Titullari i Autoritetit Kontraktor]

Shtojca 3

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE

Emri i Ofertuesit _____

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

* * *

Procedura e prokurimit: [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr.Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

1. Çmimi total i ofertës sonë është [monedha dhe vlera e ofertës]; pa TVSH;
2. Çmimi total i ofertës sonë është [monedha dhe vlera e ofertës]; me TVSH

Nr.	Përshkrimi i Mallit	Njësi	Sasia	Çmimi/Njësi
I	UNIFORMA BAZË			
1	Xhup shërbimi (3/4)(me veshje të ngrohtë)	Copë	1	
2	Xhup shërbimi (me veshje të ngrohtë)	Copë	1	
3	Kostum uniforme / meshkuj (1 Xhaketë, 2 pantallona, 2 kapele)	Komplet	1	
4	Kostum uniforme/femra (1 Xhaketë, 1 pantallona, 1 fund, 2 kapele)	Komplet	1	
5	Pulovër e trikotuar jakë “V”	Copë	1	
6	Këmishë me mëngje të gjata meshkuj	Copë	1	
7	Këmishë me mëngje të gjata femra	Copë	1	
8	Kravatë blu uniforme	Copë	1	
9	Rrip pantalloni	Copë	1	
10	Rrip multifunksional	Copë	1	
11	Jelek multifunksional	Copë	1	
12	Mushama shiu	Copë	1	
13	Dorashka lëkure	Palë	1	
14	Pulover e trikotuar me jake rrumbullake	Copë	1	
15	Pulover e trikotuat me jake 1/2 golf	Copë	1	
16	Kapuç leshi	Copë	1	
II	UNIFORMA VERORE			
1	Pantallona vere meshkuj	Palë	1	
2	Pantallona vere femra	Palë	1	
3	Fund per femra	Copë	1	
4	Pantallona vere rip stop per Rep N.SH	Palë	1	
5	Këmishë me mëngje të shkurtra, për meshkuj	Copë	1	
6	Këmishë me mëngje të shkurtra, për femra	Copë	1	
7	Bluzë me 3 kopsa, me mëngje të shkurtra për meshkuj	Copë	1	
8	Bluzë me 3 kopsa, me mëngje të shkurtra për femra	Copë	1	

“Blerje dhe shpërndarje e uniformave dhe këpucëve të Policisë së Shtetit”

9	Kapele verore meshkuj	Copë	1	
10	Kapele verore femra	Copë	1	
III	UNIFORMA PËR STËRVITJE E SHËRBIME			
1	Kostum rip-stop taktik (Xhaketë, pantallona+2 kapele).	Komplet	1	
2	Kemishe blu me minge te shkurtera	Palë	1	
3	Bluzë jakë rrumbullakët m/ gjata	Copë	1	
4	Bluzë jakë rrumbullakët m/ shkurtra	Copë	1	
IV	UNIFORMA TË VEÇANTA			
a.	Uniforma e Policisë Rrugore. Dimërore dhe verore			
1	Kostumi motoçiklisti dimeror (xhup, pantallona, 2 kapele sport)	Komplet	1	
2	Kostumi dimeror (xhup, pantallona, 2 kapele sport)	Komplet	1	
3	Pantallona doku ripstop	Palë	1	
4	Bluze pambuku 3 kopsa, me minge te shkurtera pol rrugore	Copë	1	
5	Xhup me vizibilitete te lartë	Copë	1	
6	Aksesore reflektive (mbulese kapele, mengore)	Copë	1	
7	Jelek me Vizibilitet te lartë	Copë	1	
8	Dorashka motoçiklisti pol rrugore	Palë	1	
9	Bluze pambuku 3 kopsa, me minge te gjata pol rrugore	Copë	1	
b.	Uniforma e veçantë verore për punonjësit e policisë që kryejnë shërbimin në plazhe,			
1	Bluze pambuku 3 kopsa e bardhë	Copë	1	
2	Pantallona doku ripstop te shkurtra	Palë	1	
3	Kapele tip sport	Copë	1	
d.	Uniforma e veçantë për Punonjësit e Policisë Patrulle e Pergjithshme. (Uniformë dimërore dhe verore)			
1	Kostumi dimeror (xhup, pantallona, 2 kapele sport)	Komplet	1	
2	Pantallona doku ripstop vere	Palë	1	
3	Bluza pambuku me 3 kopsa me mengë të shkurtera	Copë	1	
4	Jelek me Vizibilitet te larte	Copë	1	
5	Bluze pambuku me 3 kopsa me minge te gjata	Copë	1	
e.	Uniforma e veçantë për Punonjësit e Policisë Seksioni i Forcës së Posaçme SHQIPONJA dhe të Njësisë së Ndërhyrjes së Patrullave me Motoçikleta. (Uniformë dimërore dhe verore)			
1	Kostumi motociklisti (xhup, pantallona, 2 kapele sport)	Komplet	1	
2	Pantallona doku ripstop vere	Palë	1	
3	Bluza pambuku me 3 kopsa me mengë të shkurtëra	Copë	1	
4	Jelek me Vizibilitet te lartë	Copë	1	
5	Bluze pambuku me 3 kopsa me mengë të gjata	Copë	1	
V	Uniforma për punonjësit e Policisë të Mjeteve Ujore:			
1	Jelek shpëtimi (Mjete ujore)	Copë	1	
VI	Uniforma e Prezantimit të Policisë së Hetimit të Krimit:			
1	Jelek prezantues policia e hetimit te krimit	Copë	1	
2	Kapele doku prezantuese per hetimin e krimit	Copë	1	
VII	UNIFORMA CEREMONIALE			
1	Rrip ceremoniali	Copë	1	
2	Kemishe ceremoniale me minge te gjata, meshkuj	Copë	1	
3	Kemishe ceremoniale me minge te gjata, femra	Copë	1	

4	Dorashka ceremoniale	Copë	1	
5	Kordone supi nga Inspektor - kryekomisar	Copë	1	
6	Kordon ceremoniali supi nga Drejtues - Drejtues i Pare	Copë	1	
7	Kordone cermoniale supi Drejtues i Lartë deri Drejtues Madhor	Copë	1	
8	Kordone cermoniale kapele Inspektor - Kryekomisar	Copë	1	
9	Kordon ceremoniali kapele Drejtues - Drejtues i Parë	Copë	1	
10	Kordon ceremoniali kapele Drejtues i lartë - Drejtues Madhor	Copë	1	
VIII	Uniforma prezantuese per zyrtar e pritjes qytetareve			
1	Kostum civil per meshkuj (xhakete, pantallona) zyrtar e qytetareve	Komplet	1	
2	Kostum civil per femra (xhakete, fund)	Komplet	1	
3	Shall per femra	Copë	1	
4	Kemisha me m/gjata civile, Meshkuj	Copë	1	
5	Kemisha me m/gjata civile, femra	Copë	1	
6	Kemisha me minge te shkurtera civile, meshkuj	Copë	1	
7	Kemisha me minge te shkurtera civile, femra	Copë	1	
IX	GRADAT POLICISE SE SHETIT			
a.	Grada tubolare spaleti sherbimi			
1	Grada tubolare spaleti sherbimi "Inspektor"	Palë	1	
2	Grada tubolare spaleti sherbimi "Inspektor i dytë"	Palë	1	
3	Grada tubolare spaleti sherbimi "Inspektor i parë"	Palë	1	
4	Grada tubolare spaleti sherbimi "NENKOMISAR"	Palë	1	
5	Grada tubolare spaleti sherbimi "KOMISAR"	Palë	1	
6	Grada tubolare spaleti sherbimi "KRYEKOMISAR"	Palë	1	
7	Grada tubolare spaleti sherbimi "DREJTUES"	Palë	1	
8	Grada tubolare spaleti sherbimi "Drejtues i Pare	Palë	1	
9	Grada tubolare spaleti sherbimi "Drejtuesi Larte	Palë	1	
10	Grada tubolare spaleti sherbimi "Drejtues Madhor	Palë	1	
b.	Gradat CEREMONIALE			
1	Grada tubolare spaleti ceremoniale "Inspektor"	Palë	1	
2	Grada tubolare spaleti ceremoniale "Inspektori dytë"	Palë	1	
3	Grada tubolare spaleti ceremoniale "Inspektor i parë"	Palë	1	
4	Grada tubolare spaleti ceremoniale "Nënkomisar"	Palë	1	
5	Grada tubolare spaleti ceremoniale "Komisar"	Palë	1	
6	Grada tubolare spaleti ceremoniale "Kryekomisar"	Palë	1	
7	Grada tubolare spaleti ceremoniale "Drejtues"	Palë	1	
8	Grada tubolare spaleti ceremoniale "Drejtuesi Parë"	Palë	1	
9	Grada tubolare spaleti ceremoniale "Drejtues Lartë"	Palë	1	
10	Grada tubolare spaleti ceremoniale "Drejtues Madhor"	Palë	1	
c	Gradat e vogla te gjoksit			
1	Grade e vogel gjoksi "Inspektor"	Copë	1	
2	Grade e vogel gjoksi "Inspektor i dytë"	Copë	1	
3	Grade e vogel gjoksi "Inspektor i parë"	Copë	1	
4	Grade e vogel gjoksi "Nënkomisar"	Copë	1	
5	Grade e vogel gjoksi "Komisar"	Copë	1	
6	Grade e vogel gjoksi "Kryekomisar"	Copë	1	
7	Grade e vogel gjoksi "Drejtues"	Copë	1	

8	Grade e vogel gjoksi "Drejtues i Parë"	Copë	1	
9	Grade e vogel gjoksi "Drejtues i Lartë"	Copë	1	
10	Grade e vogel gjoksi "Drejtues Madhor"	Copë	1	
X	STEMA, SHENJAT E POLICISE SE SHTETIT			
1	Stema e policise se Shtetit	Copë	1	
2	Shenja e krahut POLICIA E RENDIT	Copë	1	
3	Shenja e krahut SHQIPONJA	Copë	1	
4	Shenja e krahut POLICIA RRUGORE	Copë	1	
5	Shenja e krahut POLICIA KUFITARE	Copë	1	
6	Shenja e krahut "RENEA"	Copë	1	
7	Shenja e krahut FNSH	Copë	1	
8	Shenje supi sherbimi kursanti/studenti	Palë	1	
9	Shenje gjoksi kursanti/studenti	Copë	1	
10	Shenje Gjoksi Mbiemri	Copë	1	
11	Shenja gjoksi numer RMIS	Copë	1	
12	Logo e Policisë së Shtetit	Copë	1	
XI	KËPUCË			
1	Këpucë ceremoniale për meshkuj	Palë	1	
2	Këpucë ceremoniale për femra	Palë	1	
3	Këpucë dimërore për femra dhe meshkuj	Palë	1	
4	Këpucë verore për meshkuj	Palë	1	
5	Këpucë verore për femra	Palë	1	
6	Këpucë taktike dimërore	Palë	1	
7	Këpucë taktike për patrullë në plazhe	Palë	1	
8	Këpucë taktike verore me qafa	Palë	1	
9	Këpucë taktike verore për strukturat e veçanta	Palë	1	
Shumatorja limit e çmimeve për njësi të uniformës (Lekë pa TVSH)			488,141	
XII	SISTEMI ELEKTRONIK I SHPËRNDARJES SË UNIFORMËS			
1	Sistemi elektronik (ëeb, aplikacioni, programi)	Copë	1	
2	Karta për punonjësit e Policisë	Copë	1	
3	Trajnime	Javë	1	
4	Mirëmbajtja	Vite	1	
Shumatorja limit e çmimeve për njësi të sistemit të shpërndarjes (Lekë pa TVSH)			21.494. 225	
Shumatorja limit e çmimeve për njësi, në total (Lekë pa TVSH)			21,982,366	

Nënshkrimi i ofertuesit _____

Vula _____

Shënim: Çmimet duhet të shprehen në Monedhën ____ (e kërkuar në dokumentat e tenderit)

Vlerësimi i Ofertës Ekonomike do të bëhet duke u bazuar vetëm në çmimin për njësi. Pikët maksimale do t'i jepen ofertuesit i cili paraqet shumatoren e çmimeve për njësi më të ulët (të artikujve të uniformës dhe të zërave të sistemit elektronik të shpërndarjes së uniformës). Në cdo rast, operatorët ekonomik duke iu referuar sasive të pritshme përkatëse, nuk duhet të tejkalojnë as shumatoren limit të artikujve të uniformës, as fondin limit të sistemit elektronik të shpërndarjes së uniformës, dhe as vlerën e pritshme të kontratës (fondin limit të marrëveshjes kuadër).

Shtojca 3/1

“Blerje dhe shpërndarje e uniformave dhe këpucëve të Policisë së Shtetit”

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

DEKLARATË

Për paraqitje Oferte të Pavarur

E operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë: _____; nga Autoriteti Kontraktor: _____; me objekt: _____; me fond limit: _____.

Unë i nënshkruari _____, me cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik _____, në mbështetje të nenit 1 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar si dhe në mbështetje të Ligjit Nr.9121/2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", bëj këtë deklaram dhe garantoj se deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

Unë vërtetoj, në interes të: _____ që:
(Emri i operatorit ekonomik)

1. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;
2. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s'kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga pjesëmarrja në prokurimet publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;
3. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;
4. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;
5. Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala "konkurrentë" nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:
 - a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;
 - b) është një ofertues potencial, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.
6. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):
 - a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;
 - b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).
7. Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:
 - a) çmimet ;
 - b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
 - c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
 - d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

8. Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).
9. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).

(Emri dhe Firma e Personit të Autorizuar për Përfaqësim të Ofertuesit)

(Titulli sipas pozicionit në punë) (Data)

Shtojca 4

[Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor ne Marrëveshjen Kuadër gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit]

FTESA PËR OFERTË

(shkruani emrin e Autoritetit Kontraktor)

fton për të paraqitur oferta në procedurën për furnizimin e mallrave të mëposhtme:

.....
.....
.....

(jepni një përshkrim të saktë të objektit të kontratës dhe sasisë siç përkufizohet në Dokumentat e Tenderit (DT)).

Vendi i Dorëzimit të Mallit

(jepni një përshkrim të shkurtër)

Malli duhet të dorëzohet brenda datës _____

Oferta duhet të paraqitet

.....

[Jep adresën e saktë]

Përpara

.....

[Përcaktoni datën dhe orën]

Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese _____

Forma e komunikimit:

Me shkrim

elektronike (email, fax, etj)

Shtojca 5

[Letër me logon e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]
[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik kur kërkohet nga autoriteti kontraktor]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

[Data_____]

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri] / Nr.Referencës në faqen e APP-se

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës ose ftesën për tender].

[Përfaqësuesi i bankës]

Shtojca 6

[Shtojcë për tu plotësuar nga operatori ekonomik]

LISTA E INFORMACIONIT KONFIDENCIAL

Shënoni më poshtë informacionin që dëshironi të mbahet konfidencial:

